



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

<b>DATË/A:</b>	<b>05.07.2019</b>
<b>REFERENC-Ë:</b>	<b>309 / 19</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>AK – Spitali i përgjithshëm “Dr. Sami Haxhi Beqiri”-Mitrovicë</b> <b>OE – “KosovaMed Healthcare”shpk</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Goran Milenković</b> <b>Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>N J O F T I M</b>

Operatori Ekonomik: OE – “KosovaMed Healthcare”shpk si palë e pa kënaqur më datën: 13.06.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 309 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje Mjekësore" me nr. të Prokurimit: 70040-19-011-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “Spitali i përgjithshëm “Dr. Sami Haxhi Beqiri”- Mitrovicë duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 20.06.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE – “KosovaMed Healthcare”shpk

Eksperti i OSHP-së më datën: 28.06.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç'rast ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës OE – “KosovaMed Healthcare”shpk është e bazuara dhe rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që *Autoriteti Kontraktues ti përmirësoj specifikimet teknike te aneksi 1 në dosjen e tenderit, në pajtim me Nenin 28 të LPP-së, te bëjë zgjatjen e afatit dhe ti njoftoj operatorët ekonomik te interesuar me ndryshimet e dosjes se tenderit.*

Me datën: 28.06.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - "Spitali i përgjithshëm "Dr. Sami Haxhi Beqiri"- Mitrovicë si dhe parashtruesi i ankesës: "KosovaMed Healthcare"shpk e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje Mjekësore" me nr. të Prokurimit: 70040-19-011-121

Autoriteti kontraktues AK- "Spitali i përgjithshëm "Dr. Sami Haxhi Beqiri"- Mitrovicë përmes parashtrësës së datës: 02.07.2019, pas pranimit të raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 28.06.2019

Operatori ekonomik: OE : "KosovaMed Healthcare"shpk përmes parashtrësës së datës: 01.06.2019 ka njoftuar OSHP-në , se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 28.06.2019

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- "Spitali i përgjithshëm "Dr. Sami Haxhi Beqiri"- Mitrovicë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje Mjekësore" me nr. të Prokurimit: 70040-19-011-121. ***Obliqohet Autoriteti Kontraktues ti përmirësoj specifikimet teknike të aneksi 1 në dosjen e tenderit, në pajtim me Nenin 28 të LPP-së, të bëjë zgjatjen e afatit dhe ti njoftoj operatorët ekonomik të interesuar me ndryshimet e dosjes së tenderit, Sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.***

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE – "KosovaMed Healthcare"shpk konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

*Përbërja e Panelit Shqyrtues:*

z. Goran Milenković \_\_\_\_\_ Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. Nuhi Paçarizi \_\_\_\_\_ Referues,

z. Blerim Dina \_\_\_\_\_ Anëtar.